Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-468
Datë 16.11.2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 31.10.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Kolegjit UBT në Prishtinë, për periudhën 3 vjeçare, prej 31. 10. 2016 deri 31. 10. 2019 për këto kualifikime të aprovuara:

   1.1. Administrator i sistemit dhe i rrjetit kompjuterik, niveli i KKK-së (V).

   Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

   Kushtet:

- Të vendosen sinjalizimet e detajuara të evakuimit në të dy objektet.
- Të zhvillohet dhe të aprovohet procedurë e shkruar për kushtet dhe kriteret e testimit.
- Të zhvillohet dhe të aprovohet procedurë për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta.
- Të dëshmohet buxheti vjetor i ndarë për zhvillim të stafit.
- Të riorganizohet stafi në zyrën për sigurimin e cilësisë.
- Të dëshmohet marrëveshja me partnerët në industri për punë praktike.

- Të dëshmohet lista e softuerëve dhe aplikacioneve si dhe licencat e tyre.
- Përshtatjen e plan programit.
- Të dëshmohet lista e harduerit të laboratorëve të serverëve dhe të rrjetit.
- Të dëshmohet lista e mësimdhënësve dhe lëndët që ata/ato ligjërojnë.
- Të ofrohet dëshmi për procedurat dhe organizimin e kopjeve rezervë.
- Mbrojtja e të dhënave personale.

(Afati kohor: 01. 02. 2017).

1.2. Zhvillues i aplikacioneve, niveli i KKK-së (V).

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Në raportet e validimit dhe akreditimit ceket se kusht për pranim është përfundimi i shkollës së mesme. Për të mos pasur diskriminim në përzgjedhje, rekomandohet që të përcaktohen qartë kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes dhe të jenë publike.
- Nëse studenti nuk e kalon testin e pjesshëm apo final, nuk dihet cila është mënyra dhe afatet e ri testimit. Rekomandohet që të zhvillohet dhe të aprovohet procedurë e shkruar për kushtet dhe kriteret e ri testimit.
- Synimit për fleksibilitet të studentëve i kontribuon njohja dhe transferi i kredive. Rekomandohet që të zhvillohet dhe aprovohet procedurë për njohjen dhe transferin e kredive, të arritura nga kandidatët në dhe nga institucione të tjera.
- Për të promovuar, mbrojtur dhe siguruar të drejta të plota dhe të barabarta të për të gjithë personat, e veçanërisht për personat me aftësi të kufizuar, si dhe për të kontribuar në respektimin e dinjitetit të tyre, rekomandohet të që zhvillohet dhe aprovohet procedurë e qartë për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta.
- Me globalizimin e tregut, pronësia intelektuale ka zënë vend të madh dhe mund të ketë implikime sa i përket mbrojtjes dhe zbatimit të të drejtave që dalin nga pronësia intelektuale. Për të shmangur këto implikime, rekomandohet që në kontratat e studentëve, mësimdhënësve dhe kolegjit UBT të përcaktohen obligimet tri paleshe mbi "Pronësinë Intelektuale" me rastin e zhvillimeve të aplikacioneve gjatë studimeve e të cilat mund të komercializohen dhe të jenë fitimprurëse.

- Në mënyrë që stafi, e në veçanti stafi mësimdhënës të mirëmbajnë dhe përditësojnë njohuritë e tyre, rekomandohet që të zhvillohet procedurë për ngritjen dhe zhvillimin e stafit, sidomos lidhur me kërkesat për vlerësim, verifikim të brendshëm dhe certifikim.

- Koordinator i zyrës së cilësisë është caktuar z. Edmond Hajrizi dhe përgjegjësit për secilin rreth. Megjithatë nuk dihet se kur është marrë ky vendim dhe për çfarë kohe janë bërë këto caktime. Rekomandohet që vendimi të përcaktojë saktë dhe qartë rolin, përgjegjësisë dhe kohëzgjatjen e caktimit.

- Vlerësimi i performancës është thelbësor për menaxhim efektiv dhe vlerësim të e stafit. Në bazë të këtij vlerësimi mund të përcaktohen edhe nevojat individuale për trajnim, prandaj rekomandohet që të zhvillohen procedura për vlerësimin e performancës së institucionit dhe të stafit.
- Profili është i lidhur ngushtë me punën praktike dhe menaxhmenti ka deklaruar se një pjesë e punës praktike do të kryhet në industri, prandaj rekomandohet kolegji UBT që të lidh marrëveshje me partnerët në industri tek të cilët do të kryhet puna praktike.

- Megjithëse ekziston kutia e ankesave, ajo është në një hapësirë të vëzhguar nga kamerat dhe si e tillë nuk mund të jetë anonime. Përveç kësaj duhet të sigurohet një zgjidhje e drejtë e shqyrtimit të ankesave në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese.

- Me qëllim të shmangies së piraterisë dhe pasi që për këtë profil janë të nevojshme aplikacione të ndryshme softuerike, rekomandohet kolegji UBT që të përpilojë listën e aplikacioneve softuerike që janë në përdorim apo do të përdoren në të ardhmen si dhe e drejta e përdorimit të tyre apo licencat.

- Struktura e përgjithshme, syllabuset dhe përshkrimet e lëndëve shpesh herë janë jo adekuate dhe kanë mospërputhje në mes vete, apo edhe pjesë të njëjta janë në disa lëndë. Këto problematika kryesisht janë hasur tek lëndët "Bazat Teknike për Informatike", "Bazat e Qarqeve Kompjuterike ", "Sisteme Operative dhe Arkitektura e Kompjuterëve", "Sistemet e bazave të të dhënave" dhe "Parallel Programing ". Rekomandohet kolegji IBT që të forcojë mekanizmat për parandalimin e mbivendosjes së pjesëve të njëjta tek disa lëndë apo edhe diferencat në mes përshkrimeve të ndryshme të lëndës.

  (Afati kohor: 01. 02. 2017).

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 31.10.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacionet për Validim të Kualifikimit/Modulit;

- Aplikacionet për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT; dhe
- AKK.

Nën- kryetari i KD së AKK
Anton Gojani